



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:133519

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644422

P.nr.2304/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale të akuzuarës E. S. S., e akuzuar për veprën penale Vjedhje neni 313 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.3568/23 të datës 14.06.2023, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 24.04.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Eset Rama dhe të akuzuarës E. S. S. me datë 24.04.2024 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 30.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara E. S, e bija e Sh. dhe nëna F., e gjinisë R., e lindur me, në Gj., me vendbanim në F. K. Rr. “R.” objekti banesor “E...” me numër personal, të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, e martuar, nënë e një fëmije e gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

Sepse:

Me dt. 14.01.2023 ne ora 13:55, në Qendrën Tregtare “A&M” në F. K, me përfaqësues V. S., e pandehura E. S, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së huaj për vete apo personin tjetër ka marr (vjedh) një jakne në vlerë përafërsisht 150 (njëqind e pesëdhjetë) euro duke e vendosur në karrocën e fëmijëve dhe ka dalë jashtë pa e paguar, (treqind0) Euro, me ç’ rast të dëmtuarit Qendrës Tregtare “A&M”, në F. K. i ka shkaktuar dëm material.

- Me këtë ka kryer veprën penale *Vjedhje* nga neni 313 par 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 43, 48, 70, 71, 72 dhe 313 par 1 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

GJYKON

- I. Me dënim me kusht, ku dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj e pandehura nuk do ta mbaj, nëse në periudhë kohore prej 1 (një) viti nuk kryer veprë të re penale dhe
- II. Me dënim me gjobë në shumën prej 300.00 (treqind) Euro te cilin dënim e akuzuara është e obliguar që ta paguaj në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Nëse e pandehura dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar më lartë, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës
- IV. Obligohet e akuzuara që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 60 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- V. I dëmtuari udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr.3568/23 të datës 14.06.2023, ndaj të akuzuarës E.S për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale Vjedhje neni 313 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 24.04.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Eset Rama dhe të pandehurës E. S. ku e njëjta u njoftuan me të drejtat e saj, me aktakuzën dhe provat kundër saj. Pas kësaj prokurori i shtetit lexoj aktakuzën kundër të pandehurës.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori e pandehura u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të pandehurës dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se e pandehura ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, e pandehura është e vetëdijshme për pasojat e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarës se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të

pandehurës E. S. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Vjedhje nga neni 313 par 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se e akuzuara e ka kryer veprën me dashje ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarës, kështu që e njëjta është penalisht përgjegjëse.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën, gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë si dhe faktin se e njëjta nuk ka qenë e dënuar më parë për ndonjë vepër penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim të nenit 43 dhe 48 të KPRK-se të akuzuarën e gjykoi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin dënim do të arrihet edhe qëllimi i përcaktuar në bazë të dispozitave ligjore.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarës është në përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të saj dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë.

Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurës në kryerjen e veprave penale ne të ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 të KPRK-se.

Duke u bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 Euro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.2304/23 datë 30.04.2024

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.